

Vëllimi 31  
2021

# SCUPI

SERI E BOTIMEVE TË VEÇANTA TË INSTITUTIT TË TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE


## GJUHA DHE SHKOLLA SHQIPE NË MAQEDONINË E VERIUT

*(konferencë e mbajtur më 24 shtator 2020)*

31



Shkup, 2021



INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE  
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

GJUHA DHE SHKOLLA  
SHQIPE NË  
MAQEDONINË E VERIUT  
*(konferencë e mbajtur më 24 shtator 2020)*

31



Shkup, 2021

Boton:  
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE  
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 31 – 2021  
Biblioteka: SCUPI

Për botuesin:  
*Prof. dr. Skender Asani*

Kryeredaktore:  
*Doc. dr. Shejnaze Ajdini–Murtezi*

Këshilli redaktues:  
*Prof. dr. Hidajete Azizi*  
*Prof. dr. Zeqirija Ibrahimi*  
*Prof. dr. Bukurije Mustafa*  
*Mr. sc. Idaete Sinani*

Copyright©ITSHKSH, 2021  
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN: 978–608–4897–44–6

[www.itsh.edu.mk](http://www.itsh.edu.mk)

*Ky botim financohet nga:*



INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE  
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

GJUHA DHE SHKOLLA  
SHQIPE NË  
MAQEDONINË E VERIUT

*(konferencë e mbajtur më 24 shtator 2020)*

31

**SCUPI**

Shkup, 2021



## PËRMBAJTJA:

DY FJALË PËR KËTË VËLLIM .....	9
Skender ASANI: Fjalë përshëndetëse .....	12
KUMTESAT E STUDIUESVE .....	15
Avzi MUSTAFA: FAKTORËT KRYESORË TË KULTURËS SË GJUHËS SHQIPE NË SHKOLLË DHE PERISPEKTIVA E SAJ .....	17
Xheladin MURATI: ARSIMI SHQIP NË MAQEDONINË E VERIUT, SFIDAT DHE PROBLEMET .....	27
Xhemaludin IDRIZI: DISA VËREJTJE GJUHËSORE NË LIBRIN “GJUHA SHQIPE DHE LEXIMI 5” PËR SHKOLLËN FILLORE ....	39
Asllan HAMITI/Gladiola ELEZI: GJUHA NË LIBRAT E PËRKTHYER TË ARSIMIT FILLOR NË SHKENCAT NATYRORE .....	53
Valbona TOSKA/Miruše HOXHA: ZËRA TË POSAÇËM NË TEKSTET SHKOLLORE TË LËNDËS MËSIMORE TË GJUHËS SHQIPE.....	71
Berton SULEJMANI: GJUHA STANDARDE SHQIPE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR TË QYTETIT TË SHKUPIT .....	78
Ismet OSMANI: VËZHGIME MBI TERMINOLOGJINË NË TEKSTET MËSIMORE NË GJUHËN SHQIPE.....	95
Izmit DURMISHI: SHQIPJA STANDARDE NË SHKOLLAT FILLORE.....	109
Bashkim IDRIZI: TERMINOLOGJIA JOADEKUATE DHE GABIMET GJUHËSORE NË LIBRAT E GJEOGRAFISË NË GJUHËN SHQIPE .....	125
Ajten HAJDARI-QAMILI: SI TA PËRMIRËSOJMË TË NXËNIT E SHQIPES STANDARDE NË SHKOLLAT E RMV-së .....	140

Luljeta ADILI – ÇELIKU/Meral SHEHABI – VESELI: GABIMET E SHPESHTA GJATË PËRDORIMIT TË GJUHËS SHQIPE NË MEDIAT E SHKRUARA.....	158
Dëfrim SALIU/Shejnaze AJDINI–MURTEZI: GJUHA FRËNGE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT.....	174
Donika BAKIU: GABIMET GJUHËSORE NË TEKSTET SHKOLLORE .....	183
Farketa DIBRA – ZEQRIRI: ROLI I LEKTYRËS SHKOLLORE NË PËRVETËSIMIN E GJUHËS STANDARDE.....	190
Bukurie MUSTAFA: DOKUMENTACIONI SHKOLLOR DHE EVIDENCA PEDAGOGJIKE BRENDË VËSHTRIMIT GJUHËSOR E HISTORIK.....	207
Shejnaze AJDINI–MURTEZI: LIBRI SHKOLLOR I GJUHËS FRËNGE NË SHKOLLAT E MESME SHQIPE NË RMV .....	225
Besnik EMINI: PËRDORIMI I GJUHËS SHQIPE NË PROCESIN ARSIMOR SIPAS LIGJEVE TË REPUBLIKËS SOCIALISTE TË MAQEDONISË.....	242
Hidajete AZIZI: GJUHA STANDARDE SHQIPE NË ARSIMIN FILLOR .....	248
Zeqirija IBRAHIMI: GJUHA SHQIPE NË SHKOLLË – NGA SIPËRFAQJA NË THELLËSI .....	280
Hana DARDHISHTA: PËRKTHIMI I TERMINOLOGJISË PROFESIONALE NË TEKSTET SHKOLLORE NË SHKOLLËN SHQIPE.....	291
Idaete SINANI: GJUHA E PËRKTHIMEVE NË TEKSTET SHKOLLORE TË ARSIMIT FILLOR ME MËSIM NË GJUHËN SHQIPE NË RMV .....	302
Besa SALIU/Shejnaze AJDINI–MURTEZI: METODAT E MËSIMDHËNIES SË GJUHËS FRËNGE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT .....	319
Ardian RAMADANI: GJUHA DHE FJALËT E PËRDORURA GABIMISHT NË TEKSTET E PËRKTHYERA.....	329



*FARKETA DIBRA – ZEQRIRI*

*Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski” – Shkup*

## ROLI I LEKTYRËS SHKOLLORE NË PËR VETËSIMIN E GJUHËS STANDARDE

Paralelisht me të folurit, të shkruarit dhe të dëgjuarit, të lexuarit është aktivitet mjaft i rëndësishëm intelektual dhe edukativ, i cili mundëson realizimin e shumë marrëdhënieve komunikative mes njerëzve. Të lexuarit është proces i rëndësishëm jetësor që çon drejt të kërkuarit të diçkaje, por njëkohësisht paraqet edhe nevojë, dëshirë emocionale të çdo individi.

Problemet e sotme mbi të lexuarit, kuptimin e të lexuarit, të lexuarit për të mësuar, aftësitë për të lexuar dhe mësimdhënien e të lexuarit kanë qenë dhe janë objekt i shpeshtë studimesh. Studiuesit amerikanë: Andersoni, Hieberti, Skoti dhe Wilkinsoni në punimin e tyre "Të bëhemi një komb lexuesish" theksojnë se: "të lexuarit është aftësi bazë jetësore. Ai është gur themeli për suksesin e fëmijës në shkollë e madje edhe gjatë gjithë jetës. Pa pasur aftësinë për të lexuar mirë, mundësitë për realizimin e vetvetes dhe për arritjen e suksesit profesional, pa dyshim që do të humbasin. Ky ndikim në jetën e secilit prej nesh i bën shumë studiues që ta quajnë leximin si një e drejtë themelore e njeriut. Është vështirë të përfytyrohet një aftësi tjetër që ta ilustrojë më mirë qëllimin e shkollimit".<sup>49</sup>

Duke e konsideruar zhvillimin e aftësisë për të lexuar si çështje parësore të mësimdhënies, të lexuarit duhet parë si një proces, si një mjet komunikimi dhe jo thjesht si një lëndë e veçantë. Gjatë

<sup>49</sup> Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009, f. 212.

procesit të të lexuarit nxënësit ndodhen para një procesi logjik dhe konjitiv të nxëni, i cili kërkon njëherazi të kuptojnë, të interpretojnë, të analizojnë, të japin konkluzione dhe të marrin vendime.

Si rrjedhojë, njëra nga lëndët bazë gjatë ciklit të shkollimit fillor dhe të mesëm, që përfshin sasi më të madhe orësh dhe që e ka mundësinë më të madhe ta zhvillojë aftësinë e të lexuarit është lënda e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Brenda kësaj lënde, mes tjerash, është përcaktuar edhe lektura si fushë më vete për t'u punuar, fushë që i nxit nxënësit të lexojnë një numër të caktuar veprash letrare për secilin vit shkollor.

Emërtimi *lekturë* nuk është i panjohur në sistemin tonë arsimor, ka traditë të gjatë në shkollat tona, daton që nga hartimi i plan-programeve të para mësimore për lëndën e gjuhës amtare.<sup>50</sup> Në terminologjinë tonë pedagogjike ky emërtim përdoret me një domethënie specifike, që vërtetohet edhe me përdorimin e emërtimeve të shumta si: lekturë letrare, lekturë shkollore, lekturë shtëpiake, lekturë e detyrueshme, lekturë e zgjedhur etj. Me përdorimin e këtyre emërtimeve synohet të bëhet kufizimi nga veprat e tjera letrare që i lexojnë nxënësit, por të cilat nuk janë të parapara si lektura shkollore.

Para së gjithash, termi *lekturë* duhet kuptuar si kategori pedagogjike. Për ta përfituar dimensionin e vërtetë pedagogjik ajo duhet të jetë në funksion të detyrave konkrete edukativo-arsimore të

---

<sup>50</sup> Pas një hulumtimi që realizuam në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë së Veriut, arritëm të sigurojmë plan-programet e lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë, duke filluar nga viti 1973-2020 edhe pse jemi të bindur se fusha e lekturës ka ekzistuar edhe më herët në plan-programet e shkollës shqipe, por në mungesë dokumentacioni, në kumtesë do t'u referohemi të dhënave që siguruam nga viti 1973 e deri më sot.

shkollës dhe mësimit të gjuhës amtare. Për këtë arsye është e domosdoshme që gjatë përcaktimit të përmbajtjes së saj të nisët nga thelbi – nxënësi. Ai është subjekt kryesor, të cilit i është kushtuar lektyra. "Ajo është vendosur në funksion të zhvillimit të tij të përgjithshëm intelektual dhe emocional, zhvillohet në vazhdimësi kohore didaktiko–metodike, fillon në klasë, vazhdon në kushte familjare/shtëpi dhe përfundon në klasë. Për ndërtimin e objektivave të saj në këtë rrafsh, janë përgjegjës dhe duhet të përgatiten si mësuesi, ashtu edhe nxënësit".<sup>51</sup>

Në çdo klasë ku mësohet dhe lexohet, mësuesi duhet të synojë që t'i mësojë nxënësit të mendojnë, përderisa lexojnë, kështu nxënësit aftësohen që të mund t'i kuptojnë porositë e autorëve dhe ta kuptojnë vizionin e tyre për botën. Sipas mënyrës se si nxënësit do të mund ta konceptojnë botën, në atë mënyrë ata do mund ta kuptojnë, se cili libër e përmbush interesimin dhe kureshtjen e tyre, cili u ndihmon t'i demonstrojnë shprehitë e tyre mjeshtërore të gjuhës dhe stilit të shkrimtarit dhe cili u jep mundësi të formojnë marrëdhënie kritike drejt mënyrës së trajtimit të problemeve jetësore që shkrimtarët i paraqesin në veprën letrare. Pra, ora e lektyrës është vendi ku fillon dhe ndërtohet procesi i të lexuarit, i cili i bashkuar me instruksionet që japin mësuesit për realizimin e të lexuarit të kuptimshëm, kanë krijuar shtratin dhe janë bërë bërthamë e krijimit të aftësive të nxënësve në lidhje me të lexuarit e tyre.<sup>52</sup>

Në këtë vazhdë nuk duhet anashkaluar roli dhe rëndësia edukativo–arsimore që ka ora e lektyrës. Fillimisht, përpjekja për ta nxitur nxënësin të punojë në mënyrë të pavarur me librin; të

<sup>51</sup> Nuhi Rexhepi, *Letërsia shqipe në tekstet shkollore të Kosovës (1945-1990)*, Logos, Prishtinë, 2002, f. 40.

<sup>52</sup> Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009, f. 218.

mundet nxënësi në mënyrë të pavarur të sjellë gjykime mbi vlerën ideo-artistike të veprës letrare; ta zgjerojë kreativitetin dhe imagjinatën; ta pasurojë fjalorin; ta përmirësojë kulturën e të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Kujtojmë se lektyra duhet kuptuar dhe përdorur si përmbajtje, mënyrë, mjet, formë, aktivitet dhe kusht për ngritjen e kulturës së leximit dhe kulturës nga letërsia që duhet të përfitojnë nxënësit. Pesha e kësaj fushe shtohet edhe me karakterin plotësues të programit, nëpërmjet saj nxënësit njihen edhe me veprat e autorëve të tjerë që nuk janë të planifikuar në plan-program dhe në këtë mënyrë i plotësojnë njohuritë e tyre të përgjithshme si gjuhësore ashtu edhe letrare.

Nisur nga vlerat dhe anët pozitive që zhvillon dhe përsos procesi i të lexuarit, gjykojmë se lektyra duhet të zë vend të veçantë në kurrikulë. Pas një rishikimi që u bëmë plan-programeve të siguruara nga Arkivi Shtetëror i Maqedonisë së Veriut, pamë se fusha e lekturës ndër vite, lë për të dëshiruar. Nga njëra anë, sistemi ideologjik i kohës e pengonte një zhvillim dhe përfaqësim normal të kësaj fushe, duke i përjashtuar emrat më në zë të shkrimtarëve të kohës; dhe nga ana tjetër, realizimi i saj në mësim as në mënyrë të organizuar dhe as në mënyrë metodike nuk i tejkalonte format tradicionale të punës dhe se akoma përballë sferave të tjera mësimore nuk gjenden lehtë rrugët për përshtatjen e shpejtë dhe funksionale të saj me nevojat e praktikës shkollore.

### *1. Lektyra shkollore në plan-programet mësimore pas viteve të '90-ta*

Programet e lëndës së gjuhë amtare pas Luftës së Dytë Botërore, duke pasur parasysh rrethanat dhe momentet nëpër të cilat kalonte zhvillimi i arsimit shqip, mund të themi se asnjëherë nuk i kanë

përmbushur kërkesat dhe nevojat e shkollës shqipe, sepse në plan të parë duhej të përmbushej ana ideologjike e më pas kërkesat e tjera shkencore e profesionale. "Përpiluesit e plan-programeve dhe të teksteve shkollore kanë qenë të gjymtuar në disa drejtime, për shkak se programet për lëndën e gjuhës shqipe dhe letërsisë deri vonë janë përshtatur nga gjuhët sllave. Ekzistonin vështirësi të mëdha për përcaktimin e vendit të autorëve në programet mësimore dhe në tekstet shkollore, shumë autorë e vepra letrare, për shkaqe ideologjike ishin përjashtuar nga programi dhe nuk mund të përfshiheshin as në procesin mësimor, as në tekstet shkollore e jo më të propozoheshin në lisën e lektyrave si vepra të zgjedhura për t'u punuar".<sup>53</sup>

Përpiluesit e plan-programeve së pari duhej të kishin parasysh raportin e përfshirjes së autorëve shqiptarë, jugosllavë e botërorë, ky raport deri vonë ishte në disavantazh për letërsinë shqipe. Kur kësaj t'i shtohet edhe përzgjedhja e autorëve dhe veprave mbi bazën e kritereve ideologjike dhe pedagogjizmi i tepruar, mund ta marrim me mend se ç'dëme të mëdha i ka sjellë kjo procesit mësimor e në veçanti lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë. "Përcaktimi i veprave letrare në fushën e lektyrës është bërë në mënyrë deduktive, sipas përshtypjeve dhe kritereve subjektive të hartuesve të plan-programit, pra jo në bazë të studimit empirik të vlerave letrare artistike, as në bazë të përshtatshmërisë së aftësive kuptimore, dëshirave dhe interesimit të nxënësve të klasave dhe moshave të caktuara".<sup>54</sup> Kështu, ndodhi të mos kishim prezantim të mirëfilltë të krijimeve letrare nga zhanret me vlerë kulminante artistike-edukative që do

<sup>53</sup> Nuhi Rexhepi, *Letërsia shqipe në tekstet shkollore të Kosovës (1945-1990)*, Logos, Prishtinë, 2002, f. 42.

<sup>54</sup> Riza Brada, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollën fillore, botimi III i plotësuar*, Dukagjini, Pejë, 2005, f. 450.

lan të  
tjera  
he të  
, për  
ë deri  
ësi të  
nësi—  
e, për  
nd të  
e jo  
ra për

të ndihmonin më shumë zhvillimin e potencialeve emocionale dhe intelektuale krijuese të nxënësve.

rasysh  
rë, ky  
kësaj  
zën e  
arrim  
r e në  
eprave  
, sipas  
ogra—  
like, as  
e dhe  
ara".<sup>54</sup>  
imeve  
që do  
-1990),  
ni III i

Nisur nga një realitet i tillë, fusha e lektyrës nuk pati trajtimin e duhur dhe të barabartë me lëndët e tjera mësimore. Madje, ka pasur raste kur lektyra është kuptuar si përmbajtje që shërben për të përmbushur zbrazëtitrat e orëve mësimore nga fushat e tjera të mësimin të gjuhës amtare. Ndonjëherë, ndodh që nxënësi të ngarkohet më shumë seç duhet me lektyra voluminoze që tejkalojnë vëllimin e të gjitha lëndëve mësimore. Në këtë mënyrë, arsimtari nuk ka liri zgjedhjeje e trajtimi të veprave letrare më bashkëkohore, por duhet të sillet në kuadër të përcaktimeve të plan-programit mësimor, jo rrallë të tejkaluara për nga përmbajtja dhe për nga vlera artistike. Ndryshe thënë, nuk ekzistonte zgjedhje e lirë e veprave për t'u punuar. Lista e lektyrave ishte e caktuar nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit dhe sipas kërkesave të plan-programit mësimor, duhej të realizoheshin të gjitha detyrat e plan-programit mësimor pa asnjë përjashtim. Kjo situatë e palakmueshme çdo ditë e më shumë shkonte në dëm të nxënësve shqiptarë, të cilët gjithë e më shumë mbeteshin me njohuri të përcipta gjuhësore, por edhe letrare si pasojë e sistemit ideologjik të kohës:

## *2. Risitë që sollën programet mësimore pas vitit 2001*

Viti 2001 la gjurmë të thella në historinë e popullit shqiptar. Kjo periudhë shënoi një kthesë të rëndësishme për një popull që nuk ka pasur të drejtën e barazisë dhe lirisë së fjalës shqipe. Me rrethanat e reja të krijuara u mundësuan intervenime dhe ripërtëritje në shumë sfera të jetës, para së gjithash në arsim, shkak i së cilës ishte edhe lufta e zhvilluar e përqendruar kryesisht në problemin gjuhësor e në zbatimin e gjuhës shqipe në nivel zyrtar. Kurrikula e deriatëhersh—

me ishte me përmbajtje ideologjike dhe pak kishte të bënte me kërkesat e gjuhës amtare për komunitetin shqiptar. Këto ndryshime bënë që kurrikula e gjuhës të shpëtojë sadopak nga boshti ideologjik, duke u orientuar drejt zhvillimit bashkëkohor dhe të vendoset theksi drejt aftësimin dhe zotërimin aktiv të gjuhës shqipe nga ana e nxënësve shqiptarë. Gjatë kësaj periudhe kurrikula e gjuhës shqipe shënoi zhvillimin më të shpejtë e më cilësor krahasuar me të kaluarën, duke u pasuruar me: programe të reja të gjuhës shqipe; me standarde të reja vlerësimi; me standarde përmbajtjeje dhe arritjeje; me tekste të arsimit bazë për të gjitha ciklet e shkollimit, njëherazi edhe me ndryshime në listën e lektyrave.

Në plan-programet që pasuan pas vitit 2001 me të cilat edhe aktualisht punohet në shkollat e mesme në Maqedoninë e Veriut, lista e lektyrave është zhveshur tërësisht nga ndikimi nacional, fillimisht kryesohet nga autorë shqiptarë, pasuar nga ata botërorë si dhe ndonjë vepër e propozuar sipas dëshirës së nxënësve dhe në bashkëpunim me mësimdhënësin, mund të punohet nga autorë sllavë. Një përparësi e madhe ekziston edhe në përzgjedhjen e veprave, tani më zgjedhja e lektyrave nuk bëhet nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit, por zgjedhja e tyre është një hap i lirë dhe demokratik. Byroja propozon një listë të gjatë veprash për t'u punuar si lektyra, ndërsa përzgjedhja bëhet nga trekëndëshi prind-profesor-nxënës. Ky hap i lirë dhe demokratik ndikon pozitivisht në shumë aspekte, në radhë të parë u jep mundësi nxënësve për të qenë më afër veprës së dëshiruar, e cila i përgjigjet botës dhe interesimit të tij individual dhe emocional.

Parë nga këndvështrimi i sotëm, kanë kaluar dy dekada nga ndryshimet dhe intervenimet e fundit, bota ec përpara me hapa të shpejta, zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit e

ka ndryshuar botën anakënd. Kujtojmë, se ka ardhur koha që lista e lektyrave të rishikohet, mbase edhe të rifreskohet me tituj të rinj që i përgjigjen botës, kërkesave, prirjeve dhe shijeve estetike të nxënësve. Pra, nevojiten zëra të rinj për ta plotësuar dhe ndryshuar vendin e kësaj fushe, për ta avancuar kuptimin dhe rëndësinë çfarë ka puna e mirë me lektyrën dhe për ta ndihmuar përpunimin e saj në frymën e kërkesave të programeve të reja mësimore, strategjive e teknikave bashkëkohore të mësimdhënies.

### *3. Përfitimet gjuhësore që sjell leximi i lektyrave*

Lënda e gjuhës dhe letërsisë shqipe në sistemin tonë arsimor gjithmonë ke ekzistuar e shkruar bashkë me letërsinë. Lidhur me këtë shkrimje, vazhdimisht ka pasur debate dhe polemika, ku studiues, profesorë, metodistë, specialistë të gjuhës e të letërsisë kanë shprehur mendimin dhe bindjen se gjuha duhet të mësohen e ndarë nga letërsia, meqë në orët e gjuhës duhet të mësohet vetëm gjuhë dhe në orët e letërsisë të mësohet vetëm letërsi. Kjo shkëputje mes mësimin të gjuhës dhe të letërsisë bën që nxënësit të mos jenë në gjendje t'i përvetësojnë aq sa duhet as njohuritë gjuhësore e as ato letrare, duke mbetur me njohuri gjysmake nga të dyja disiplinat. Për t'i dhënë jetë mendimit të tyre, mbështesin idenë se nuk ka rëndësi zotërimi i sistemit gramatikor të gjuhës, por aftësimi i nxënësve për t'u shprehur me gojë dhe me shkrim në situatat e ndryshme ligjërimore që do t'u paraqiten në jetë.

Lidhur me këto mendime dhe ide, nuk munguan as zërat që i kundërvihen kësaj ndarjeje, duke u shprehur: "se nuk mund të kemi një gjuhë të pastër pa një tekst letrar dhe nuk mund të kemi një tekst letrar pa një analizë gjuhësore të mirëfilltë. Kështu që në



këtë kuptim në një formim të përgjithshëm të nxënësve u vjen në ndihmë atyre, pasi të mësuarit me kompetenca që është një risi e viteve të fundit nxjerr domosdoshmëri fitimin e disa aftësive për jetën." <sup>55</sup>

Zërat që mbështesin mësimin e integruar të gjuhës me letërsinë shprehen se: mësimi i gjuhës patjetër duhet të jetë i integruar me atë të letërsisë, "gjuha shqipe i duhet letërsisë, sepse letërsi të bukur pa gjuhë të mirë, të pasur e të kujdesur nuk ka e nuk mund të ketë, por edhe letërsia i duhet gjuhës, sepse vetë letërsia e pasuron gjuhën".<sup>56</sup> Letërsia realizohet nëpërmjet gjuhës si materie kryesore dhe jashtë saj ajo nuk mund të krijohet, të ekzistojë, të komunikojë dhe as të ndikojë estetikisht. Pra, letërsia është mënyra më e mirë për t'i bërë njerëzit të kuptojnë se mësimi më i përshtatshëm i gjuhës është pikërisht nëpërmjet letërsisë dhe leximit të veprave letrare.

Mbi bazën e këtyre mendimeve, gjykojmë se nuk mund të kemi një të folur të saktë, të bukur dhe shprehës, nëse nuk ekziston një integrimi i tillë. Ky integrim ndihmon nxënësit që nëpërmjet letërsisë të thellohet formimi gjuhësor i tyre, duke u shkrirë elementet e gjuhës me letërsinë. Një objektiv të tillë e hasim edhe në programin mësimor për arsimin e mesëm, ku mes tjerash sugjerohet që njohuritë gramatikore, rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit duhet të integrohen me studimin e teksteve përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, informuese—paraqitëse, me qëllim që mos të krijohen përshtypje të gabuara se këto disiplina

<sup>55</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/mesues-e-pedagoge-njezeri-gjuha-dhe-letersia-te-ndahen-nga-njeratjeta-domosdoshmeri-e-kohes-shkarkuar-me-18.09.2020>

<sup>56</sup> <https://kallarati.com/blog/446-ndarja-e-gjuhes-nga-letersia-ekspertet-ne-debat-shkarkuar-me-10.09.2020>.

nuk e kanë vlerën e njëjtë dhe se njëra apo tjetra mund të ndihmojë me shumë ose më pak në formimin gjuhësor ose letrar të nxënësit.

Shpeshherë krijohet përshtypje se në kurrikulë i është lënë hapësirë më e madhe përvetësimit të rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe atyre të pikësimit, si një risi e diktuar nga fakti që nxënësit tanë shfaqnin probleme në këto fusha dhe nuk po arrijnë t'i përvetësojnë normat e shqipes standarde. Megjithëkëtë, duhet kuptuar qartë fakti se gjuha nuk është vetëm gramatikë dhe se gramatika është vetëm një pjesë e gjuhës. Natyrisht që një përdorues i mirë i shqipes, është ai që e zotëron standardin dhe rregullat e gramatikës, por nëse kurrikula do të fokusohet vetëm te gramatika, formimi gjuhësor i nxënësve do të ishte i përciptë.<sup>57</sup> Rregullat e thata gramatikore, pa i konkretizuar në gjuhën e folur ose të shkruar, do ta bënë gjuhën shqipe për nxënësit, të huaj, megjithëse ajo është amtare për ta.

"Gjuha e folur, që të ndihmojë sa më mirë gjuhën e shkruar, nxënësit duhet të nxiten e të drejtohen të mësojnë gjuhën e librave (të librave artistikë, të librave shkencor e të biznesit). Mbi ta duhet të ushtrohet ndikim pozitiv që përfiton kënaqësi dhe tërheqje drejt leximit, duke kërkuar që nxënësit ta memorizojnë dhe ta përdorin për qëllime të caktuara aktin e të shkruarit".<sup>58</sup> Pra, vijmë në një konstatim se jo vetëm gramatika ndihmon nxënësit të flasin në gjuhën standarde, por përvetësimin e normave padyshim se e ndihmon leximi i veprave letrare.

Nxënësi do të jetë në gjendje t'i zotërojë më mirë katër aftësitë gjuhësore: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit, në rast se

---

<sup>57</sup> <http://www.portalishkollor.al/news/ardi-stefa-ndarja-e-gjuhes-shqipe-nga-letersia-qe-ne-9-vjecare-domosdoshmeri>, shkarkuar me 18.09.2020.

<sup>58</sup> Haki Baçi - Njazi Kazazi, *Gjuha dhe ligjërimin në shkollë*, Studime shqiptare 10, Shkodër, 1998, f. 181.

gjendet ekuilibri i nevojshëm mes parapëlqimeve të tija dhe teksteve që detyrohet t'i lexojë në lëndët mësimore. Nëse arrihet ky harmonizim, nxënësit jo vetëm që do të jenë në gjendje të fitojnë njohuri të gjuhës, por ata edhe do të ndjejnë kënaqësi prej asaj që kanë lexuar. Kjo nga ana tjetër siguron motivimin, i cili rrit aftësitë e leximit. Me fjalë të tjera, nëse nxënësit janë të interesuar për atë që e lexojnë, ata jo vetëm që fillojnë t'i përvetësojnë më lehtësisht aftësitë themelore gjuhësore, por e konceptojnë dhe e kuptojnë vazhdimisht atë që e lexojnë.<sup>59</sup>

Përfitimet gjuhësore që sjell leximi i lektyrave, padyshim se janë të shumta dhe të natyrës së ndryshme, megjithëkëtë si më të rëndësishme kemi veçuar:

- Zhvillimi gjuhësor i nxënësve, si dhe pasurimi i fjalorit të tyre. Nëpërmjet leximit të veprave të ndryshme, nxënësit njihen me modelet më të mira të përdorimit të gjuhës dhe kanë mundësi të zgjerojnë aftësitë e tyre për të formuar fjali në mënyra të ndryshme, të organizojnë mendimet dhe pjesët e tekstit në formate të ndryshme, si dhe të përzgjedhin fjalorin që përshtatet në mënyrë të saktë me një mendim ose veprim.
- Leximi i lektyrave ndihmon nxënësit të mësojnë shkathtësitë e të hartuarit dhe të shkruarit, duke u futur në botën e krijimeve më të mira të letërsisë botërore dhe asaj kombëtare. Nxënësit mësojnë shumë edhe nga leximi i krijimtarisë popullore: nga përrallat, legjendat, këngët lirike dhe epike e veçanërisht nga fjalët e urta e gjëgjëzat, të cilat dallohen për strukturë të përkryer gjuhësore, pasuri informacioni që bartin dhe bukuri shprehjeje.

<sup>59</sup> <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2016/12/Thesis-Final-Alb.pdf> f. 5, shkarkuar më 18. 09. 2020.

- Njëherazi, zbulojnë kënaqësinë e të lexuarit të letërsisë dhe bëhen të vetëdijshëm për shumësinë e mënyrave të perceptimit të botës përreth tyre; gjykojnë për vlerat estetike të gjuhës në një tekst letrar; lidhin tekstin që lexojnë me jetën dhe përvojat e tyre, si dhe me botën që i rrethon;
- Letërsia është autentike dhe siguron informacion autentik për mësimin e gjuhës. Ajo mund të jetë veçanërisht e pasqyruar në drama dhe romane, ku gjithsecili ndeshet me dialogje, shprehje emocionale dhe përshkrime të ngjarjeve me elemente që nxisin imagjinatën e gjithsecilit. Letërsia ofron materiale autentike me vlerë, të cilat stimulojnë zhvillimin personal të nxënësit dhe kontribuon në pasurimin kulturor dhe gjuhësor të tij. Një përfitim i tillë vjen nga përfshirja personale që nxit letërsia, pasi ajo bën që nxënësit të jenë më entuziastë dhe më të lidhur me historitë dhe personazhet e ngërthyera brenda një vepre letrare.
- Leximi i lektyrave ndikon në një edukim ndërkulturor, sepse të njohësh kultura të ndryshme nëpërmjet veprave të letërsisë evropiane dhe botërore rezulton në perceptimin më të thellë të asaj kulture, e cila me vonë rrit aftësinë e nxënësve në komunikim ndërkulturor.<sup>60</sup>

Natyrisht, se procesi i përvetësimit të gjithë këtyre njohurive nuk mund të arrihet brenda një ore mësimi, meqë ky është proces i gjatë dhe kompleks, para se gjithash kërkon punë, këmbëngulje dhe vullnet nga të dy palët. Barra në masë të madhe i bie mësimdhënësit, i cili që t'u mundësojë nxënësve një përvetësim të normës standarde, si në të folur ashtu edhe në të shkruar, duhet të zgjedhë vepra që nuk i privojnë nxënësit prej suksesit për shkak të

---

<sup>60</sup> <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2016/12/Thesis-Final-Alb.pdf> f. 6, shkarkuar më 18. 09. 2020.

vështirësive gjuhësore. Nxënësve duhet t'u jepen vepra që janë paksa mbi nivelin e tyre, në mënyrë që, përveçse të jenë në gjendje të kuptojnë se çfarë janë duke lexuar, po ashtu ata duhet të nxiten që ta shtyjnë veten për të kuptuar koncepte të reja, të cilat mund të shfaqen në vepër drejtpërsëdrejti a tërthorazi.

Leximi i veprave të ndryshme letrare sjell dobi jo vetëm në përmirësimin e aftësive të të folurit, por edhe të të shkruarit. Kjo është më e dallueshme veçanërisht në strukturimin e një fjalie. Një fjali e shkruar mirë ka si forcën gramatikore, ashtu dhe aftësinë për të lidhur ide me njëra-tjetrën. Kështu, sa më shumë që lexojnë nxënësit, aq më shumë përmirësohen në aftësinë e tyre të të shkruarit, për shkak se janë duke u ekspozuar ndaj formacioneve dhe funksioneve të ndryshme të një fjalie, duke e bërë këtë, lexuesit kuptojnë se ata janë të aftë të mësojnë gramatikën dhe fjalorin e gjuhës.<sup>61</sup>

Në praktikë, procesi i përfitimit të aftësive gjuhësore gjatë orës së interpretimit të lekturës mund të realizohet në mënyra nga më të ndryshmet, varësisht nga gjinia dhe lloji letrar të cilës i përket ajo vepër. P.sh. nxënësve mund t'u jepet si detyrë leximi i një romani brenda një harku kohor prej një jave, pa qenë nevoja për ta përdorur edhe aq shumë fjalorin shpjegues të gjuhës. Një praktikë e këtillë, jo vetëm që do ta dyfishonte shpejtësinë e leximit të tyre, por edhe do t'i shtynte ata që të mendojnë vet sipas situatës kontekstuale të përdorimit rreth kuptimit të fjalëve të panjohura në vepër. Nga ana tjetër, veprat më të mira letrare për lexime intensive mund të jenë poezitë. Poezia të jep më shumë mundësi për analiza të hollësishme. Kështu, nxënësve mund t'u kërkohet që ta lexojnë

<sup>61</sup> <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2016/12/Thesis-Final-Alb.pdf> f. 5, shkarkuar më 18. 09. 2020.

çdo strofë ndaras, në mënyrë që të depërtojnë më shumë në përmbajtjen e saj dhe për të zbuluar konotacionet e shumta të fjalëve përmes tropeve letrare, si metafora, krahasimi apo alegoria etj.<sup>62</sup>

Një ushtrim tjetër mund të jetë ai ku nxënësve t'u kërkohet që tekstin e një poezie ta kthejnë sipas normave standarde të gjuhës. Letërsia është lënda gjuhësore ku ndihen më së shumti thyerjet e normës sintaksore të standardit, si inversioni apo thyerja e përmbysja e vargut.<sup>63</sup> Në këtë vazhdë, duke ditur se sistemi i gjuhës shqipe ka mundësi të mëdha shprehëse, lind nevoja që gjatë interpretimit të lekturës të përdoren edhe mundësitë që paraqiten edhe në fonetikë, në morfologji e në fjalëformim, në leksik e në sintaksë.

**Në fonetikë:** efektet shprehëse që lindin nga shqiptimi, nga përdorimi i theksave etj.

**Në morfologji:** përdorimi i shumësit për njëjës, ndërtimi jo i rregullt i gjinisë femërore nga mashkullorja për efekte stilistike, përdorimi i mbiemrit për të futur emrin në një fushë të caktuar ligjërimi; përdorimi i foljes në joveprore në vend të veprores, i urdhërores në vend të lidhores, përdorimet me vlera të mëdha shprehëse të habitores dhe dëshirores etj., përdorimi i numërorëve për fuqizimin e hiperbolizmit etj.

**Në fjalëformim:** përdorimi i neologjizmave, i prapashtesave me kuptim keqësues e zvogëlues dhe i kompozitave.

**Në leksik:** përdorimi i polisemisë, sinonimisë, antonimisë etj.

Si përfundim, nga e gjithë kjo që trajtuam, mund të konstatojmë se në orën e analizës së lekturës të mos rrëmohet për të gjetur element

---

<sup>62</sup> Po aty, f. 6.

<sup>63</sup> Faik Luli, *Metodika e letërsisë dhe e leximit letrar*, Tiranë, 1984, f. 66.

të gjetur, të paqenë apo dytësor, por në mënyrë të natyrshme, pa shkaktuar mbingarkesë, të trajtohen në rrugë praktike ato elemente gjuhësore që nxjerrin më mirë në pah përmbajtjen, idenë, vlerat artistike të veprës që trajtohet. Pra, lidhja e gjuhës me letërsinë të burojë nga vetë përmbajtja e materialit letrar dhe nga forma e temës mësimore. Ngritja e kulturës gjuhësore nëpërmjet letërsisë bëhet për qëllime praktike, në shërbim të përvetësimit më të thellë të letërsisë, por edhe të gjuhës, pa të cilën ajo nuk mund të ekzistojë, në shërbim të përsosjes të të folurit dhe të të shkruarit të nxënësve me normën e gjuhës letrare kombëtare. Ato elemente gjuhësore që evidentohen në mësimin e letërsisë, nxënësit jo vetëm duhet t'i njohin e t'i shfrytëzojnë në orën e mësimin, por duhet ngulmuar që t'i përdorin edhe në ligjërimin me gojë dhe me shkrim.<sup>64</sup>

Kërkesa për t'i aftësuar nxënësit për zotërimin e të lexuarit, mendojmë se është shprehur dhe materializuar saktë në kurrikulën e gjuhës dhe të letërsisë. Mbetet detyrë e mësuesve ta njohin mirë atë, të krijojnë vizion të qartë e të punojnë me objektiva të afërta e të largëta me efektivitet synimet e vëna.

### *Bibliografia:*

1. Baçi, Haki – Kazazi, Njazi: *Gjuha dhe ligjërimin në shkollë*, Studime shqiptare 10, Shkodër, 1998.
2. Begolli, Menduh, *Lektyra e detyrueshme dhe ora e saj në shkollë*, Buletini nr. 3-4, Prishtinë, 1962.
2. Brada, Riza, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollën fillore (botimi III i plotësuar)*, Dukagjini, Pejë, 2005.
3. Gjokutaj, Mimoza: *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009.

<sup>64</sup> Po aty, f. 66.

4. Luli, Faik, *Metodika e letërsisë dhe e leximit letrar*, Tiranë, 1984.
5. Rexhepi, Nuhi, *Letërsia shqipe në tekstet shkollore të Kosovës (1945–1990)*, Logos, Prishtinë, 2002.
6. Plani dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe për fazën përgatitore, Arkivi Shtetëror i Maqedonisë së Veriut, Shkup, 1973, shifra e dokumentit – 0801–35.
7. Plani dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe në kohë lufte për shkollat e mesme, Arkivi Shtetëror i Maqedonisë së Veriut, Shkup, 1978, kutia 23.
8. Plani dhe programi mësimor për veprimtarinë edukativo–arsimore për shkollat e mesme, Prosvetno dello, Shkup, 1989.
9. Plani dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe në kohë lufte për shkollat e mesme, Arkivi Shtetëror i Maqedonisë së Veriut, Shkup, 1980, kutia 23.
10. Plani dhe programi mësimor për veprimtarinë edukativo–arsimore në shkollimin e mesëm, Arkivi Shtetëror i Maqedonisë së Veriut, Shkup, 1984, kutia 29.
11. Plani dhe programi mësimor për veprimtarinë edukativo–arsimore në shkollimin e mesëm, Arkivi Shtetëror i Maqedonisë së Veriut, Shkup, 1988, kutia 30–34.
12. Plani dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe për gjimnaze, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit të Maqedonisë së Veriut, Shkup, 1991.
13. Plani dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe për gjimnaze – viti i parë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Byroja për Zhvillimin e Arsimit të Maqedonisë së Veriut, Shkup, 2001.
14. Plani dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe për gjimnaze – viti i dytë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e



Maqedonisë së Veriut, Byroja për Zhvillimin e Arsimit të Maqedonisë së Veriut, Shkup, 2002.

Y15. Plani dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe për gjimnaze – viti i tretë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Byroja për Zhvillimin e Arsimit të Maqedonisë së Veriut, Shkup, 2003.

16. Plani dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe për gjimnaze – viti i katërt, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Byroja e Zhvillimit të Arsimit të Maqedonisë së Veriut, Shkup, 2003.

17. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2016/12/Thesis-Final-Alb.pdf>, shkarkuar më 18. 09. 2020.

18. <https://shqiptarja.com/lajm/mesues-e-pedagoge-njezeri-gjuha-dhe-letersia-te-ndahen-nga-njeratjetra-domosdoshmeri-e-kohes>, shkarkuar më 18. 09. 2020

19. <https://kallarati.com/blog/446-ndarja-e-gjuhes-nga-letersia-ekspertet-ne-debat>, shkarkuar më 10.09.2020.

20. <http://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/11/Edukimi-estetik-i-nx%C3%ABn%C3%ABsve-me-CIP.pdf>, shkarkuar më 20.09.2020.

